



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Senatit  
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 198/004  
Dt 14.02.2018

Në bazë të nenit 48, pika 1.3, të Statutit të Përkohshëm, Senati i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 9.2.2018, mori:

**VENDIM**

- I. Refuzohet si e pabazë ankesa e Rifat Morinës me nr. 1453 të datës 16.10.2017, e paraqitur kundër vendimit të Senatit për rizgjedhjen e tij në titullin profesor asistent për lëndët: Biokimia e përgjithshme; Proceset bioteknologjike në industrinë ushqimore; dhe Gjenetika molekulare, në bazë të konkursit të shpallur më 16.06.2017 nga Universitetit i Mitrovicës "Isa Boletini".
- II. Vërtetohet në tërësi raporti i Komisionit recensues dhe vendimi i Senatit me nr. prot. 1403/004 të datës 10.10.2017, për rizgjedhjen e Rifat Morinës në titullin profesor asistent për lëndët: Biokimia e përgjithshme; Proceset bioteknologjike në industrinë ushqimore; dhe Gjenetika molekulare në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

**Arsyetim**


Universiteti i Mitrovicës ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: Biokimia e përgjithshme; Proceset bioteknologjike në industrinë ushqimore; dhe Gjenetika molekulare në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini".

Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 9.2.2018, duke pasur parasysh propozimin e Komisionit për ankesa dhe parashtresa, u pajtua plotësisht me propozimin e Komisionit të Studimeve, sepse kandidati nuk i plotëson kriteret e parapara me nenin 156, pika 1.2 të Statutit për t'u avancuar në titullin profesor i asocuar për lëndët e lartpërmendura. Në bazë të kësaj që u tha më sipër, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, MASHT-it.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Të përmendurit;
3. Fakultetit;
4. Zyrtarit ligjor.



Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Kryesues i Senatit